


STUDIM I SHKATHHTËSIVE TË NEVOJSHME NË SEKTORIN E NDËRTIMIT NË KOSOVË

ME FOKUS TË VEÇANTË PËR PUNËTORËT PËR
VENDOSJEN E BETONIT, PËRFUNDIMIN E BETONIT DHE
TË NGJASHËM



**STUDIM I SHKATHTËSIVE TË NEVOJSHME
NË SEKTORIN E NDËRTIMIT NË KOSOVË:
ME FOKUS TË VEÇANTË PËR PUNËTORËT
PËR VENDOSJEN E BETONIT,
PËRFUNDIMIN E BETONIT DHE TË
NGJASHËM**

Shtator 2017

Lista e shkurtesave

APRK	Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës
IHD	Investimet e Huaja Direkte
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto
AL	Arsim i Lartë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional



Ky studim është përgatitur me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti për Arsim dhe Punësim në Kosovë – KEEN ” menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtje

1. Hyrje dhe metodologjia	6
2. Pasqyrë e përgjithshme e sektorit të ndërtimit.....	9
2.1 Përmasat e sektorit.....	9
2.2 Punësimi	11
2.3 Kërkesa për punë	13
2.3.1 Kërkesa aktuale për punë: Vende të lira të regjistruara	13
2.3.2 Parashikimet e ardhshme të kërkesave për punë	14
2.3.3 Niveli i arsimit: niveli tipik dhe i preferuar i arsimit.....	16
2.3.4 Vështirësitë në rekrutimin e punëtorëve të shkathtë	18
2.4 Ofrimi i fuqisë punëtore dhe ngritja e shkathtësive.....	18
2.4.1 Ofrimi i fuqisë punëtore nga shkollat e mesme profesionale	18
2.4.2 Ofrimi i fuqisë punëtore nga Qendrat e Aftësimi Profesional.....	19
2.4.3 Prurjet me fuqi punëtore nga arsimi i lartë	19
2.4.4 Ngritja e shkathtësive në ndërmarrje	19
2.4.5 Bashkëpunimi mes punëdhënësve dhe ofruesve të fuqisë punëtore	20
3. Shkathtësitë e nevojshme për punëtorët për vendosjen e betonit, përfunduesve të betonit dhe të ngjashëm.....	21
3.1 Arsimi, vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira të punës dhe ofrimin e trajnimeve	21
3.2 Detyrat dhe shkathtësitë specifike të profesionit të punëtorëve të betonit.....	22
3.3 Shkathtësitë që kërkohen për kryerjen në mënyrë adekuate të detyrave nga ana e një punëtori të betonit.....	23
3.4 Kërkesat për shkathtësi të përgjithshme	24
3.5 Shtytësit e ndryshimit, ndikimi në kërkesat për shkathtësi.....	27
3.6 Kushtet e punës dhe përgatitja fizike e punëtorëve që kërkohet.....	27
4. Komente përmbyllëse dhe rekomandime	28
Referencat.....	32
Shtojca 1: Profesionet në sektorin e shkathtësive të Ndërtimit (ISCO-08)	33

Lista e figurave dhe tabelave

Figura 1: Vlera e Shtuar Bruto e sektorit të ndërtimit (në milion Euro).....	9
Figura 2: Pjesëmarrja qarkullimit të sektorit të ndërtimit, 2008-2015 (në %).....	10
Figura 3: Numri i personave të punësuar në sektorin e ndërtimit, 2008-2015	12
Figura 4: Niveli i pagave mesatare, 2008-2015.....	13
Figura 5: Pritjet për tre vitet e ardhshme, për qarkullimin, punësimet dhe eksportet.....	14
Figura 6: Niveli/lloji tipik dhe i preferuar i arsimit për punëtorët e betonit	21
Tabela 1: Investimet e Huaja Direkte në sektorin e ndërtimit 2009-2016 (në milion Euro)	9
Tabela 2: Numri i ndërmarrjeve aktive, të reja dhe atyre që kanë ndërprerë afarizmi	10
Tabela 3: Punësimet në sektorin e ndërtimit, 2012-2016 (në 000)	11
Tabela 4: Punësimet sipas profesioneve	12
Tabela 5: Numri i vendeve të lira të punës dhe punësimet e ndërmjetësuar nëpërmjet Shërbimeve Publike të Punësimi	14
Tabela 6: Pritjet e punësimeve për tre vitet e ardhshme, sipas profesioneve	15
Tabela 7: Planet për investime për tri vitet e ardhshme.....	16
Tabela 8: Niveli i arsimit tipik dhe i preferuar sipas profesioneve.....	16
Tabela 9: Vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira të punës	18
Tabela 10: Numri i nxënësve të regjistruar dhe totali i nxënësve në shkollat e AAP: viti shkollor 2015/16 dhe 2016/17	18
Tabela 11: Numri i pjesëmarrësve të trajnuar në programin e trajnimit për ndërtimtarë në QAP në vitin 2015 dhe 2016	19
Tabela 12: Numri i studentëve të regjistruar dhe aktivë në nivelin BA në Fakultetin e Ndërtimit dhe Arkitekturës: viti akademik 2016/17	19
Tabela 13: Ofrimi i trajnimeve	20
Tabela 14: Bashkëpunimi mes sektorit të ndërtimit, atij arsimor dhe ofruesve të trajnimit	20
Tabela 15: Përgjigje në shkathtësitë e reja	21
Tabela 16: Detyrat e një punëtori të betonit	22
Tabela 17: Niveli i shkathtësive të domosdoshme të leximit, shkrimit, numërtimit dhe aftësive kompjuterike	25
Tabela 18: Shkalla e rëndësisë së shkathtësive tjera	26
Tabela 19: Ndikimi i ndryshimeve/inovacioneve në detyrat e punëtorëve të betonit.....	27
Tabela 20: Kushtet e punës.....	28

1. Hyrje dhe metodologjia

Sektori i ndërtimit në Kosovë luan një rol të rëndësishëm në Bruto Produktin Vendor (GDP) dhe në punësim pasi që gjeneron kërkesa për sektorë të tjerë duke mundësuar kështu efekte të shumëfishta në ekonomi. Mesatarisht, vlera e shtuar bruto¹ e sektorit është rreth tetë për qind ndërsa përfshin rreth një të dhjetën e qarkullimit të përgjithshëm. Ai përbën 13 për qind të Investimeve të Huaja Direkte - neto dhe bartë në vete 15 për qind të punësimeve të përgjithshme të vendit. Megjithatë, sektori po zgjerohet dhe zhvillohet vazhdimisht, gjë që karakterizohet me një numër të madh të ndërmarrjeve të reja, investimeve dhe inovacioneve.

Niveli i shkathtësive të fuqisë punëtore është identifikuar si pengesë për zhvillimin e sektorit të ndërtimit sikurse edhe në sektorë të tjerë. Prandaj, cilësia e arsimit dhe harmonizimi i tij me nevojat e tregut të punës, me fokus të veçantë në arsimin profesional, janë identifikuar si fusha kyçe për ndërhyrje në dokumentet kryesore strategjike të Qeverisë së Kosovës. Në këtë aspekt, Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (2017-2021) e njeh si sfidë kryesore lidhjen e arsimit profesional me tregun e punës dhe mungesat në zhvillimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Ngjashëm me këtë, edhe Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (2016-2020) e pranon harmonizimin e aftësive të fuqisë punëtore me nevojat e tregut të punës si parakusht për rritjen e investimeve, punësimin, të ardhurave dhe rritjes së ndërmarrjeve ekzistuese të cilat do të përktheheshin në rritje ekonomike më të madhe dhe në një zhvillim më të qëndrueshëm.

Edhe pse sektori kontribuon në masë të madhe në ekonomi, lidhur me të nuk janë bërë hulumtime sa duhet, veçanërisht në fushën e shkathtësive të nevojshme. Studimet ekzistuese (S&D, 2015; Riinvest, 2013) ofrojnë një vlerësim të përgjithshëm për sektorin duke theksuar mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar si pengesë për zhvillimin e tij. Ky studim plotëson mungesën e dëshmimeve të nevojshme duke ofruar informata shtesë për sektorin dhe një perspektivë mbi shkathtësitë e nevojshme dhe mungesat me të cilat ballafaqohen punëdhënësit krahas informacioneve të hollësishme për profesionet kryesore që mbizotërojnë.

Metodologjia e përdorur në këtë studim bazohet në literaturën/metodologjitë e mëparshme për shkathtësitë e nevojshme në Kosovë (ALLED, 2016a, b, UNDP, 2016), si dhe studimet në vendet tjera të cilat, ngjashëm me këtë, bëjnë kombinimin e nivelit të qasjes mes sektorit dhe profesionit (p.sh. shiko profilin e sektorit të drurit në Lituani nga ana e MCVET, 2008). Në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga ALLED (2016a, b), studimi analizon kërkesën dhe ofertën e shkathtësive të këtij sektori në sektorin e ndërtimit duke bashkuar informacionin rreth punësimin dhe vendeve të lira të punës (kërkesa për fuqi punëtore) dhe numrin e studentëve/praktikantëve në programet relevante studimore/të trajnimit në shkollat profesionale dhe arsimin e lartë (oferta për fuqi punëtore), në përputhje me metodologjinë e hartuar nga ALLED, 2016a, b). Analiza bazohet në: (i) studimet e mëparshme; (ii) të dhënat dytësore nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Agjencia e Punësimin në Republikën e Kosovës (APRK). Për më shumë, ky studim ofron edhe informacione nga të dhënat e dorës së parë të mbledhura nëpërmjet një studimi të shtatëdhjetë e një (71) ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e ndërtimit dhe nëpërmjet intervistave me përfaqësuesit e dy (2) ndërmarrjeve.

Përveç kësaj, studimi bazohet në të dhënat e mëparshme mbi këtë sektor, respektivisht mbi "Vlerësimin e tregut për sektorin e ndërtimit" (S&D, 2015). Studimi ofron informacione për

ofruesit e shkathtësive dhe hartuesit e politikave në zhvillimin e shkathtësive të punësimin për t'iu përshtatur kërkesave ekzistuese të tregut. Gjetjet mund që drejtpërdrejtë të përdoren për të zhvilluar standarde profesionale për punëtorët për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe të ngjashëm, duke mbështetur kështu finalizimin e kornizës profesionale të AAP-vë.

Një pasqyrë e përgjithshme mbi sektorin është nxjerrë në bazë të statistikave zyrtare mbi vlerën bruto të shtuar, numrin e ndërmarrjeve të reja dhe të mbyllura dhe shkallën e Investimeve të Huaja Direkte neto.

Mostra për anketimin e ndërmarrjeve është nxjerrë nga regjistri i ndërmarrjeve në ATK (2016). Regjistri përmban ndërmarrje që ishin aktive, d.m.th. ato të cilat ose kanë deklaruar një nga tatimet ose një person të punësuar gjatë vitit 2016. Në kuadër të kësaj mostre janë mbuluar ndërmarrjet e përfshira në sektorin e ndërtimit të objekteve rezidenciale dhe jo-rezidenciale (NACE Rev.2 kodi 41.2).

Duke pasur parasysh qëllimin e studimit, nga mostra e marrë janë përzgjedhur kompani të mëdha nën supozimin se përfaqësuesit e tyre janë më të informuar në lidhje me shkathtësitë e fuqisë punëtore, shkathtësitë e nevojshme për profesionin dhe trendet në kuptim të shkathtësive të nevojshme në të ardhmen dhe perspektivat e zhvillimit të përgjithshëm të këtij profesioni/sektori. Lidhur me këtë, është vendosur një prag i madhësisë së kompanive me mbi 10 punëtorë të regjistruar. Të gjitha kompanitë me mbi 50 punëtorë të regjistruar në regjistrin e ATK-së (deri në vitin 2016) u përzgjedhën për mostër, ndërsa pjesa tjetër e kompanive të përzgjedhura kishte 10-49 punonjës të regjistruar.

Gjithsej janë intervistuar 71 ndërmarrje, 28 për qind e të cilave ishin ndërmarrje me më shumë se 50 punëtorë; ndërsa 72 për qind ishin me 10-49 të punësuar. Ndërtimi i objekteve ishte aktiviteti kryesor për 70 për qind të të gjitha ndërmarrjeve, pasuar nga ndërtimi i shtëpive për 14 për qind dhe pjesa e mbetur e ndërmarrjeve nuk ishin të specializuara por t'u angazhuara në sektorin e ndërtimit në përgjithësi. Në shumicën e intervistave, përgjigjet janë ofruar nga pronari (56%), pasuar nga menaxherët. Bazuar në përgjigjet e pranuar nga 52 ndërmarrje, mesatarisht, ndërmarrjet punësonin 38 punëtorë të rregullt dhe 23 punëtorë sezonalë. Duke qenë se mostra nuk është përfaqësuese, treguesit specifik sasior të sektorit shfrytëzojnë të dhëna zyrtare nga ASK, ATK dhe Banka Qendrore e Kosovës, ndërkohë që përgjigjet cilësore paraqesin informacion të besueshëm për këtë sektor.

Analiza për profesionin e përzgjedhur "Punëtorët për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe të ngjashëm" (ISCO 08 Kodi 7114) bazohet në metodologjinë e përgatitur dhe pilotuar më parë nga UNDP (2016) dhe ALLED, me gjetjet të cilat janë validuar dhe fuqizuar edhe më tej nga intervistat me përfaqësuesit e kompanive Redoni dhe KNAUF.

Për shkak të mungesës së dëshmimeve të besueshme për profesionet më të kërkuara të sektorit, përzgjedhja e profesionit është bërë në bazë të dëshmimeve nga vendet e tjera dhe në bazë të konsultimeve me dy kompani të shquara ndërtimi në Kosovë (Redoni dhe Tregtia). Bazuar në hulumtimin e të dhënave ekzistuese dhe vlerësimin e ndërmarrjeve të konsultuara, profesioni më i kërkuar që angazhon një pjesë të konsiderueshme të të punësuarve në këtë sektor është profesioni i punëtorëve për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe të ngjashëm, i cili është zgjedhur për hetim të hollësishëm të aftësive të nevojshme në këtë studim. Përveç kësaj, është gjetur se, deri më tani, nuk ekziston një standard profesional i aprovuar nga Autoriteti

¹ Vlera bruto e shtuar te çmimi bazë është e barabartë me prodhimin me çmime bazë, minus konsumi i ndërmjetëm me çmimin e blerësit.

Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)². Lista e profesioneve relevante për sektorin e ndërtimit është dhënë në Shtojcën 1.

Pyetësi i anketës është organizuar sipas moduleve në vijim: **Moduli 1** përmbante pyetje lidhur me hollësitë e firmës duke përfshirë: a) informacionin mbi aktivitetin ekonomik; investimet, eksportet, punësimet sipas gjinisë, moshës, profesioneve; mënyra e punësimit (e rregullt kundrejt asaj sezonale); vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira të punës; trajnimet; informata të hollësishme për profesionin e zgjedhur (numri i të punësuarve dhe shpërndarja sipas gjinisë, moshës dhe arsimit); b) Pyetjet lidhur me pritjet për të ardhmen, sa i përket punësimit, qarkullimit, eksportet dhe investimet; c) aspektet e arsimit dhe aftësimin profesional, p.sh. rishikimin e shkathtësive dhe ofrimin e trajnimeve; dhe d) Pyetjet për statusin dhe fushat e bashkëpunimit ndërmjet sektorit dhe ofruesve të fuqisë punëtore. **Moduli 2** është përqendruar në detyrat specifike profesionale për profesionin e zgjedhur. Për secilën nga detyrat specifike të profesioneve, të përfshira në përshkrimin ISCO-08 për punëtorët e betonit, ndërmarrjeve u janë bërë pyetjet e mëposhtme: nëse punëtorët e betonit aktualisht po kryejnë detyrën, nëse ata do të duhej ta kryejnë detyrën; nëse rëndësia e detyrës do të rritet në të ardhmen. Për më tepër, ndërmarrjeve iu kërkua të listonin tri shkathtësi kryesore përkatëse që kërkohen për të arritur rezultatet e pritshme të punës. Përveç kësaj, u morën informacione për shkathtësitë e reja të nevojshme që po shfaqen dhe masat e ndërmarra nga bizneset për t'i adresuar ato. **Moduli 3** mbuloi rëndësinë dhe gatishmërinë e punëtorëve për të arritur shkathtësitë përgjithshme dhe **Moduli 4** përfshiu pyetjet për rrethanat e ndryshimeve dhe risitë kryesore të prezantuara në bizneset e intervistuar dhe ndikimi i tyre në grupin dominues profesional.

Seksioni 2 jep informacion mbi zhvillimet e fundit në sektor dhe perspektivën për të ardhmen, kërkesën dhe ofertën për punë dhe ngritjen e shkathtësive. Seksioni 3 diskuton gjetjet nga shkathtësitë e nevojshme për profesionin e përzgjedhur të punëtorëve për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe të ngjashëm, me fokus të veçantë në detyrat e kryera dhe aftësitë specifike dhe të përgjithshme profesionale që kërkohen. Seksioni 4 jep disa vërejtje dhe rekomandime përmbyllëse.

Për qëllime thjeshtësimi, gjatë gjithë raportit, titulli punëtorët e betonit do t'i referohet Punëtorëve për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe punëtorëve të ngjashëm.


² Një standard që lidhet me profesionin në sektorin e përpunimit të drurit, "Dizajni i brendshëm dhe teknologjia e drurit" është zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; megjithatë deri tani, kjo nuk është aprovuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

2. Pasqyrë e përgjithshme e sektorit të ndërtimit

2.1 Përmasat e sektorit

Sektori i ndërtimit vazhdon të mbetet një nga sektorët kryesorë që kontribuojnë në BPV-në. Sektori jep një kontribut të rëndësishëm në punësim dhe nxitë rritjen ekonomike duke stimuluar kërkesën në shumë fusha të tjera të ekonomisë. Në këtë drejtim, gjatë gjithë periudhës 2009-2016, kontributi i sektorit në BPV ishte midis 6 dhe 7.5 përqind (Figura 1). Në terma absolutë, në vitin 2016, kontributi i sektorit të ndërtimit në BPV arriti në 402 milionë euro. Sektori po rritet dhe po zhvillohet, duke u larguar nga tregu i nxitur nga ofertat në një treg më shumë të shtyrë nga kërkesa ku klientët, gjithnjë e më shumë po kërkojnë cilësi (S&D, 2014).

Figura 1: Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) e sektorit të ndërtimit (në milion Euro)



Burimi: ASK DATA

Përveç vitit 2014, neto prurjet nga investimet e huaja direkte (IHD) në sektorin e ndërtimit ishin pozitive (Tabela 1). Mesatarisht, 13 për qind e totalit të IHD-ve ishin orientuar në këtë sektor, megjithëse kryesisht të shtyra nga investimet e Diasporës (S&D, 2014).

Tabela 1: Investimet e Huaja Direkte në sektorin e ndërtimit 2009-2016 (në milion Euro)

Viti	IHD	IHD në ndërtimtari	Pjesëmarrja në totalin e IHD-ve
2009	287.4	35.5	12%
2010	368.5	54.2	15%
2011	384.4	133.1	35%
2012	229.1	31.1	14%
2013	280.2	17.3	6%
2014	151.2	-19.9	-13%
2015	308.8	46.3	15%
2016	215.9	28.2	13%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës: <http://bqk-kos.org/?id=55>

Në vitin 2015, ka pasur 2,269 ndërmarrje aktive që përfaqësojnë tetë përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Të dhënat sipas periudhave kohore që janë në dispozicion nga ASK, tregojnë se gjatë periudhës 2009-2014, ndërmarrjet në sektorin e ndërtimit përbënin rreth 7

për qind të totalit të subjekteve afariste (Tabela 2). Sektori është shumë dinamik, me një numër të madh të ndërmarrjeve të reja, me rreth 8,000 ndërmarrje të themeluara në vit. Nga ana tjetër, norma e mbylljes së ndërmarrjeve në këtë sektor është relativisht e ulët. Gjatë periudhës 2009 - 2016, norma mesatare e ndërmarrjeve të reja në raport me ato që kanë ndërprerë afarizmin ishte 6.3 që nënkupton se për secilën nga ndërmarrjet që kanë ndërprerë afarizmin janë themeluar 6 ndërmarrje të reja .


Tabela 2: Numri i ndërmarrjeve aktive, të reja dhe atyre që kanë ndërprerë afarizmi

	Numri i ndërmarrjeve aktive	% e totalit të ndërmarrjeve	Ndërmarrjet e reja	Ndërmarrjet që kanë ndërprerë afarizmin	Të reja/të mbyllura
2009	2,456	6%	7,505	1,136	6.61
2010	2,564	6%	7,729	1,363	5.67
2011	2,702	7%	7,879	924	8.53
2012	3,038	7%	9,592	1,081	8.87
2013	2,094	7%	9,421	1,508	6.25
2014	2,150	7%	9,405	1,671	5.63
2015	2,629	8%	9,833	2,205	4.46
2016 (TM1 TM2)			5,697	1,384	4.12

Burimi: ASKDATA; ASK, 2016, Rezultatet e Statistikave Strukturore të Biznesit 2015

Gjatë periudhës 2008-2014, mesatarisht, një e dhjeta e qarkullimit të përgjithshëm të inkasuar nga ndërmarrjet³ është bërë nga sektori i ndërtimit (Figura 2). Në vitin 2015, kontributi i sektorit në qarkullimin e përgjithshëm ishte 10.1 për qind, që tregon një rritje prej 1.7 pikë përqind krahasuar me 2014.

Figura 2: Pjesëmarrja qarkullimit të sektorit të ndërtimit, 2008-2015 (në %)



Burimi: ASKDATA; ASK, 2016, Rezultatet e Statistikave Strukturore të Biznesit 2015

³ Vlera e qarkullimit përfshin shumën e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së referencës dhe korrespondon me shitjet në treg të mallrave dhe shërbimeve që u ofrohen të tjerëve.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga anketa e zbatuar për këtë studim, gjatë dy viteve të fundit (2015 dhe 2016), një pjesë e madhe e ndërmarrjeve kanë investuar në tokë, ndërtesa dhe makineri, me 47 përqind; 61 për qind; dhe 90 për qind sipas radhës. Aktivitetet e sektorit kryesisht ndodhin brenda Kosovës me vetëm disa nga ndërmarrjet që janë angazhuar në aktivitetet e eksportit. Lidhur me këtë çështje, vetëm 9 nga 71 ndërmarrjet e intervistuar ishin angazhuar në aktivitetet e eksportit, kryesisht në rajon (6 prej tyre në rajon, 3 në BE dhe një në vende të tjera).⁴

2.2 Punësimi

Sipas të dhënave nga Anketa me Fuqinë Punëtore të Kosovës (AFP), ndërmjet 2012 dhe 2016, punësimet në sektor ndryshonin midis 28.000 dhe 39.000 (Tabela 3). Për më tepër, krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016, punësimet u rritën me 37 përqind, duke regjistruar shifrën prej 38.600 të punësuar. Fuqia punëtore në këtë sektor është shumë e dominuar nga meshkujt, ndërsa femrat përfaqësojnë vetëm 1 përqind të punësimeve në këtë sektor. Në terma absolutë, në vitin 2016, sektori punësoi vetëm 400 femra në krahasim me 38.200 burra.

Sektori është një punëdhënës i rëndësishëm për meshkujt pasi që ai akomodon rreth 15 përqind të meshkujve të punësuar, por vetëm 0.5 përqind prej tyre janë femra. Kjo mund të jetë rezultat i ndarjes gjinore në sistemin arsimor dhe stereotipeve mbizotëruese gjinore.

Tabela 3: Punësimet në sektorin e ndërtimit, 2012-2016 (në 000)

	Numri i të punësuarve në ndërtimtarin			Pjesëmarrja në totalin e punësimeve		
	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	Totali
2012	28.7	0.3	29.0	11.9	0.4	9.5
2013	38.2	0.8	39.0	14.5	0.9	11.4
2014	34.7	0.9	35.6	13.9	1.2	10.9
2015	27.7	0.5	28.2	12.0	0.7	9.5
2016	38.2	0.4	38.6	14.7	0.5	11.5

Burimi: Të dhënat e KAS, ASK: <http://askdata.rks.gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/>


Nga ana tjetër, Anketa për Statistikat Strukturore të Bizneseve (2015) tregon një përqindje më të vogël të punëtorëve krahasuar me AFP-në. Lidhur me këtë, raporti thekson se numri i punësimeve në sektor ishte 15.354 që përfaqëson gjysmën e numrit të përgjithshëm të të punësuarve të regjistruar nga AFP-ja. Mospërputhja e paraqitur midis këtyre dy burimeve vjen kryesisht nga mbizotërimi i punësimeve joformale⁵ dhe sezonale⁶ në këtë sektor të cilat janë gjetur më mirë përmes AFP-s pasi kjo e fundit mbledh drejtpërdrejtë të dhëna nga individët. Diskutimet me dy ndërmarrje ndërtimore, konfirmuan se numri i të punësuarve në këtë sektor është shumë më i madh se statistikat zyrtare.

⁴ Ndërmarrjet janë pyetur të tregojnë tri tregje kryesore të eksportit.

⁵ Sipas sondazhit Riinvest në vitin 2013, vlerësohet se 20 përqind e punësimit në sektor është joformal.

⁶ Një studim i realizuar nga EYE në vitin 2014, gjeti se 77% e kompanive të anketuara treguan se ata punësojnë punëtorë sezonalë, megjithëse përqindja e këtyre punonjësve nuk është raportuar.

Figura 3: Numri i personave të punësuar në sektorin e ndërtimit, 2008-2015



Burimi: ASKDATA; ASK, 2016, Rezultatet e Statistikave Strukturore të Biznesit 2015

Rreth dy të tretat e punonjësve janë të punësuar në ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha. Rreth një e katërta janë të punësuar në ndërmarrjet me 2-9 të punësuar, ndërsa të vetëpunësuarit përfaqësojnë vetëm 8 përqind të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në këtë sektor (KOSME, 2014).

Bazuar në përgjigjet e pranuar nga 52 ndërmarrje, mesatarisht, ndërmarrjet punësojnë 38 punëtor të rregullt dhe 23 punëtorë sezonalë. Profesionet më të zakonshme janë ato për vendosjen e betonit dhe përfunduesit e betonit të punësuar në 96 për qind të ndërmarrjeve, të ndjekura nga muratorët (në 90% të ndërmarrjeve); për ndërtimin e kulmit (në 83% të ndërmarrjeve); punëtorët e izolimit (në 66% të ndërmarrjeve); dhe punëtorët e suvatimit, shtrimit të dyshemeve dhe atyre për ngjyrosje të punësuar në gati 42-45 për qind të ndërmarrjeve të intervistuar (Tabela 4).

Tabela 4: Punësimet sipas profesioneve


	Punëtorët për beton	Punëtorët për ndërtimin e kulmit	Muratorët	Punëtorët për izolim	Shtresit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave	Suvatues	Punëtorët për ngjyrosje
Numri i ndërmarrjeve që punësojnë profesionet e caktuara	96%	83%	90%	66%	44%	45%	42%
Mesatarja e numrit të punëtorëve	8	8	11.2	7.3	6.7	8.8	8.4
Numri minimal-maksimal i punëtorëve	1-80	2-30	2-45	2-30	1-20	1-40	2-50

Burimi: Të dhënat nga anketa

Numri mesatar i punëtorëve për vendosjen e betonit është tetë, megjithëse ndryshon shumë mes ndërmarrjeve, që sillet nga 1 deri në 80 të punësuar.

Siç është paraqitur në Figurën 4, sektori, megjithëse me paga më të ulëta se niveli i pagës mesatare, i është nënshtruar rritjes së vazhdueshme pozitive.

Figura 4: Niveli i pagave mesatare, 2008-2015



Burimi: ASKDATA; ASK, 2016, Rezultatet e Statistikave Strukturore të Biznesit 2015

2.3 Kërkesa për punë

2.3.1 Kërkesa aktuale për punë: Vende të lira të regjistruara

Nuk ka të dhëna të besueshme për kërkesat aktuale dhe të ardhshme për punë në Kosovë. Burimi i vetëm në dispozicion për kërkesat aktuale është Agjencia e Punësimit, përmes Zyrave të Punësimit. Sidoqoftë, statistikave për vendet e lira të punës duhet të trajtohen me kujdes sepse shërbimet publike të punësimit nuk arrijnë të identifikojnë të gjitha vendet e lira të punës për dy arsye kryesore: ndërmarrjet nuk raportojnë për vende të lira pune dhe zyrtarët e punësimit mbështeten vetëm në vizitat në terren për të identifikuar vendet e lira të punës (d.m.th. ata nuk përdorin burime tjera të informatave si portalet private për vende të lira të punës). Për më tepër, siç u theksua gjatë intervistave me dy punëdhënës, ndërmarrjet që veprojnë në sektorin e ndërtimit rrallë herë publikojnë vendet e lira të punës, por në vend të kësaj mbështeten në kanale joformale të rekrutimit.

Në vitin 2016 kishte gjithsej 1,244 vende të lira pune të identifikuara nga Shërbimet Publike të Punësimit (SHPP), që përbëjnë gati 10 përqind të numrit të përgjithshëm të vendeve të lira të punës (Tabela 5). Në të njëjtin vit, SHPP-ja ndërmjetësoi për punësim 459 të papunë në sektor, duke përbërë 11.4 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmjetësimit në punësim. Sa i përket numrit të vendeve të lira të punës dhe ndërmjetësimit të punësimit përmes shërbimeve të SHPP-së vërehen ndryshime të mëdha.⁷ Futja e sistemit për vlerësimin e rezultateve të punës⁸ paraqet një nga faktorët kontribues për rritjen e numrit të vendeve të lira të identifikuara të punës.

⁷ Raporti vjetor i Punës dhe Fuqisë Punëtore i vitit 2015 nuk ofron të dhëna nga aktivitetet ekonomike.

⁸ Vlerësimi i performancës së këshilltarëve të punësimit, ndër të tjera, merr parasysh numrin e vendeve të lira të identifikuara në terren, në drejtim të përmbushjes së caqeve të përcaktuara çdo vit për secilin SHPP.

Tabela 5: Numri i vendeve të lira të punës dhe punësimet e ndërmjetësuarra nëpërmjet Shërbimeve Publike të Punësimi


	2012	2013	2014	2016
Numri i vendeve të lira	1,929	651	598	1,244
Numri i të punësuarve përmes ndërmjetësimeve nga SHPP-s	1,326	408	534	459

Burimi: MPMS, Raportet vjetore 2014 dhe 2016 të Punës dhe Fuqisë Punëtore.

2.3.2 Parashikimet e kërkesave për punë në të ardhmen

Kosova nuk ka një sistem që parashikon kërkesa për shkathtësi në tregun e punës (NDS 2016-2020). Prandaj, për të mbushur këtë boshllëk, për sektorin në fjalë, punëdhënësit e intervistuar u pyetën për pritjet e tyre në të ardhmen lidhur me punësimet, qarkullimin, eksportet dhe investimet, për tre vitet e ardhshme në sektorin e ndërtimit. Rezultatet e anketës tregojnë se pothuajse dy të tretat e ndërmarrjeve (nga 68 të anketuar) deklaruan se sektori po rritet; 26 për qind deklaruan se sektori do të mbetet në nivel të njëjtë; dhe vetëm 9 për qind thanë se sektori është në rënie. Po ashtu, pothuajse 70 për qind e ndërmarrjeve presin që shkalla e punësimi në sektorin e ndërtimit të rritet, 66 për qind parashikojnë rritje në qarkullim dhe 34 për qind deklaruan se eksportet e sektorit do të rriten në tre vitet e ardhshme (Figura 5). Pjesa e ndërmarrjeve që presin rënie në punësim, qarkullim apo rënie të eksporteve, në periudhën afatmesme, është relativisht e vogël (varion midis 3-7%).

Figura 5: Pritjet për tre vitet e ardhshme, për qarkullimin, punësimet dhe eksportet



Burimi: Sondazhi. Për eksportet, për jo-eksportuesit, planet për të filluar eksportin regjistrohen si rritje

Të ndara sipas profesioneve, 62 për qind e ndërmarrjeve të intervistuar presin që punësimet të rriten për punëtorët për vendosjen e betonit; 58 për qind presin që numri i muratorëve të rritet, e ndjekur nga 45 për qind për ndërtuesit e kulmeve; 34 për qind për suvatuesit; dhe 27 për qind e ndërmarrjeve deklarojnë se numri i punëtorëve për ngjyrosje dhe atyre të izolimit do të rritet në tre vitet e ardhshme (Tabela 6). Ndërmarrjet tjera kryesisht presin stagnim në numrin e punëtorëve, me pak prej tyre parashikojnë një rënie në profesionet e përzgjedhura.

Tabela 6: Pritjet e punësimeve për tre vitet e ardhshme, sipas profesioneve

Profesionet	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve
Punëtorët për vendosjen e betonit	
Rritje	62%
Rënie	1%
Pa ndryshime	31%
Nuk e dinë	6%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71
Punëtorët për ndërtimin e kulmeve	
Rritje	45%
Rënie	4%
Pa ndryshim	41%
Nuk e dinë	10%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71
Muratorët	
Rritje	58%
Rënie	1%
Pa ndryshim	33%
Nuk e dinë	8%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71
Punëtorët e izolimit	
Rritje	37%
Rënie	4%
Pa ndryshime	42%
Nuk e dinë	17%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71
Shtruesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave	
Rritje	27%
Rënie	3%
Pa ndryshim	46%
Nuk e dinë	24%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71
Suvatuesit	
Rritje	34%
Rënie	4%
Pa ndryshim	41%
Nuk e dinë	21%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71

Punëtorët për ngjyrosje	
Rritje	27%
Rënie	3%
Pa ndryshime	45%
Nuk e dinë	25%
Totali	100%
Numri i vëzhgimeve	71

Burimi: Të dhënat nga anketa

Sa i përket investimeve, pothuajse të gjitha ndërmarrjet planifikojnë të investojnë në makineri (94% nga 71), 56 dhe 52 për qind planifikojnë të investojnë në ndërtesa dhe makineri të reja, respektivisht (Tabela 6).

Tabela 7: Planet për investime për tri vitet e ardhshme

	Tokë	Ndërtesa	Makineri
Plane për investime	52%	56%	94%
Nuk planifikojnë investime	48%	44%	6%

Burimi: Të dhënat nga anketa

2.3.3 Niveli i arsimit: niveli tipik dhe i preferuar i arsimit

Për profesionet e zgjedhura, ndërmarrjeve iu kërkua të tregonin nivelin më të zakonshëm dhe të preferuar të arsimit. Të dhënat e paraqitura në Tabelën 8 tregojnë se për të gjitha profesionet, niveli më tipik i arsimit është arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnazi). Megjithatë, rreth dy të tretat e ndërmarrjeve kanë deklaruar se niveli më i preferuar i arsimit, për çdo profesion, është arsimi i mesëm profesional. Kjo mospërputhje mund të jetë për shkak të kombinimit të një numrit të faktorëve, duke përfshirë: daljen e pamjaftueshme të të diplomuarve nga arsimi i mesëm profesional për sektorin, mungesën e informacionit ndërmjet punëdhënësve rreth shkollave përkatëse dhe mungesën e kënaqësisë të punëdhënësit me të diplomuarit nga këto shkolla. Kjo gjithashtu nënkupton se sektori po operon me punëtorë të cilët kanë nevojë për trajnime në të gjitha aspektet e punës dhe mund të jenë me produktivitet më të ulët krahasuar me homologët e tyre nga qendrat për AAP-të. Nga perspektiva e politikave, kjo nënkupton që avancimi i cilësisë dhe rëndësisë së arsimit të mesëm profesional krahas informimit efektiv të sektorit privat dhe bashkëpunimit me të mund të përmirësojë perspektivën e punësimit të të diplomuarve në arsimin e mesëm.

Tabela 8: Niveli i arsimit tipik dhe i preferuar sipas profesioneve

Punëtorët për vendosjen e betonit		
	Niveli tipik i arsimit	Niveli i preferuar i arsimit
Shkolla fillore	4%	11%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	81%	24%
Shkollat për AAP	10%	62%
Arsimi i lart	4%	3%
Numri i vëzhgimeve	67	66
Punëtorët për ndërtimin e kulmeve		
Shkolla fillore	3%	9%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	84%	21%
Shkollat për AAP	12%	67%

Shkollimi i lart		
Numri i vëzhgimeve	58	57
Muratorët		
Shkolla fillore	3%	7%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	87%	25%
Shkollat për AAP	10%	69%
Shkollimi i lart		
Numri i vëzhgimeve	62	61
Punëtorët për izolim		
Shkolla fillore	4%	5%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	91%	30%
Shkollat për AAP	4%	65%
Shkollimi i lart		
Numri i vëzhgimeve	45	41
Shtresët e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave		
Shkolla fillore	6%	6%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	91%	42%
Shkollat për AAP	3%	52%
Shkollimi i lart		
Numri i vëzhgimeve	32	31
Suvatuesit		
Shkolla fillore	6%	6%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	91%	25%
Shkollat për AAP	3%	69%
Shkollimi i lart		
Numri i vëzhgimeve	32	32
Punëtorët për ngjyrosje		
Shkolla fillore	14%	10%
Shkolla e mesme e përgjithshme (gjimnazi)	76%	24%
Shkollat për AAP	7%	66%
Shkollimi i lart		
Numri i vëzhgimeve	29	29

Burimi: të dhënat nga anketa

2.3.4 Vështirësitë në rekrutimin e punëtorëve të shkathtë

Me këtë studim konfirmohet mungesa e fuqisë punëtore të aftë në të gjitha profesionet e përzgjedhura, ku tregohet se mes 52 dhe 62 për qind të ndërmarrjeve që kanë pasur vende të lira pune janë përballur me vështirësi në rekrutimin e tyre (Tabela 9).

Tabela 9: Vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira të punës

	Punëtorët për vendosjen e betonit	Punëtorët për ndërtimin e kulmeve	Muratorët	Punëtorët për izolim	Shtuesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave	Suvatuesit	Punëtorët për ngjyrosje
Pjesa e ndërmarrjeve që janë përballur me vështirësi në plotësimin e vendeve të punës	52%	58%	51%	62%	52%	55%	57%
Numri i ndërmarrjeve që kanë pasur vende të lira të punës	62	55	59	42	29	31	28

Burimi: Të dhënat nga anketa

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën 9, mund të vërehet se shumica dërrmuese e ndërmarrjeve të intervistuar kanë pasur vende të lira pune për punëtorët për vendosjen e betonit, muratorë dhe për punëtorët për ndërtimin e kulmeve duke konfirmuar kështu se këto profesione janë më të kërkuarat.

2.4 Ofrimi i fuqisë punëtore dhe ngritja e shkathtësive

2.4.1 Ofrimi i fuqisë punëtore nga shkollat e mesme profesionale

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 10 tregojnë se aktualisht shkollat AAP ofrojnë 4 profile të ndryshme të studimit, përkatësisht në: 1) Teknologjinë e materialit ndërtimor; 2) Ndërtim; 3) Ndërtim i ulët dhe 4) Ndërtim i lartë. Gjatë vitit shkollor 2016/17, ishin 908 nxënës (klasat 10 - 13) që ndjekin arsimin e mesëm të lartë profesional në fushën e ndërtimit. Këto programe studimi dominohen kryesisht nga meshkujt, pasi që nxënëset femra përfaqësojnë vetëm 27 përqind të totalit (Tabela 5) dhe pa asnjë nxënës femër të regjistruar në programin e studimeve të ndërtimit të lartë. Në shkollat e AAP është vërejtur një rënie e trendit të regjistrimit, ku numri i nxënësve të regjistruar në vitin 2015/16 ishte 348, numër që zbriti në 233 në vitin shkollor 2016/17, duke treguar rënie prej 33 përqind për dy vite rradhazi.

Tabela 10: Numri i nxënësve të regjistruar dhe totali i nxënësve në shkollat e AAP: viti shkollor 2015/16 dhe 2016/17

Profili i studimit	2015/16			2016/17		
	Të regjistruar/prurjet e reja	Numri/fo ndi i nxënësve	Pjesëm arrja e femrave	Të regjistruar/prurjet e reja	Numri/fo ndi i nxënësve	Pjesëm arrja e femrave
Teknologjia e materialit ndërtimor	42	82	46%	32	86	40%
Ndërtimtaria	131	363	16%	174	400	22%
Ndërtimi i Ulët	154	290	39%	20	337	37%
Ndërtimi i Lartë	21	35	0%	7	85	0%
Totali		770	27%	233	908	27%

Burimi: MASHT, 2017

2.4.2 Ofrimi i fuqisë punëtore nga Qendrat e Aftësimi Profesional

Kurset e trajnimit ofrohen nga QAP në Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë. Në vitin 2016, gjithsej morën pjesë 457 pjesëmarrës në programin e trajnimit për Ndërtimtari, krahasuar me 226 që ishin duke u trajnuar në 2015 (Tabela 11). Kjo shënon një rritje të konsiderueshme prej gati 70 përqind. E njëjta vlen edhe për numrin e pjesëmarrësve të certifikuar. Që nga viti 2017, në përputhje me klasifikimin e profesioneve të ISCO-08, QAP-të kanë riorganizuar programin e aftësimi në ndërtimtari sipas profesioneve në vijim: Punëtorët për përfundimin e betonit, punëtorët për vendosjen e betonit dhe punëtorët e ngjashëm (7114); Punëtorët për ndërtimin e kulmeve (7121); Shtuesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave (7122); Suvatuesit (7123); Muratorët dhe Punëtorët e Ngjashëm (7112); Punëtorët për ngjyrosje dhe punëtorët e ngjashëm (7131).

Tabela 11: Numri i pjesëmarrësve të trajnuar në programin e trajnimit për ndërtimtari në QAP në vitin 2015 dhe 2016

QAP-t	2015		2016	
	Numri i pjesëmarrësve të trajnuar	Numri i pjesëmarrësve të certifikuar	Numri i pjesëmarrësve të trajnuar	Numri i pjesëmarrësve të certifikuar
Prishtinë	50	44	88	83
Mitrovicë	64	57	102	87
Pejë	158	125	267	206
Total	272	226	457	376

MPMS, Raportet vjetore të Punës dhe Fuqisë punëtore për vitin 2015 dhe 2016.

2.4.3 Prurjet me fuqi punëtore nga arsimiti i lartë

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës i Universitetit të Prishtinës ofrojnë programet e studimeve në vijim: Ndërtimtari (BA dhe MA); Hidroteknikë (BA dhe MA); Gjeodezi (BA); dhe Infrastruktura Rrugore (MA). Në vitin akademik 2016/17, gjithsej 2.524 studentë kanë ndjekur studimet në fushat që lidhen me ndërtimtari, ndërsa numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë ishte 343 (Tabela 12). Studentët femra përfaqësojnë vetëm 12 përqind të numrit të përgjithshëm të studentëve, 22 përqind në programin e studimit për Hidroteknikë dhe vetëm 6 përqind në programin e studimit të Gjeodezisë.

Tabela 12: Numri i studentëve të regjistruar dhe aktivë në nivelin BA në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës: viti akademik 2016/17

	Të regjistruar	Numri i përgjithshëm i studentëve aktiv	Pjesëmarrja e femrave
Ndërtim	170	849	15%
Hidroteknikë Teknikë	80	413	22%
Gjeodezi	93	1,262	6%
Totali	343	2,524	12%

Burimi: Agjencia e Kosovës për Akreditim, Shtator 2017

2.4.4 Ngritja e shkathtësive në ndërmarrje

Sipas të dhënave të mbledhura për këtë studim, rreth tri të pestat e ndërmarrjeve bëjnë rishikimin e rregullt të shkathtësive të nevojshme për të gjithë punëtorët (38% e ndërmarrjeve) ose për një grup të punëtorëve (37% e ndërmarrjeve), ndërsa rreth një e pesta e tyre nuk bëjnë një rishikim të tillë (Tabela 13). Megjithatë shqyrtimi i shkathtësive është mjaft i zakonshëm, të dhënat tregojnë se vetëm 30 përqind e ndërmarrjeve kanë raportuar se punëtorët kanë marrë pjesë në

ndonjë kurs trajnimi të jashtëm ose të brendshëm, të paguar tërësisht ose pjesërisht nga ndërmarrja.

Trajnimi në vendin e punës është qasja më e zakonshme e trajnimit të zbatuar nga 55 përqind e ndërmarrjeve (Tabela 10). Trajnimi i dytë më i zakonshëm ka të bëjë me ciklet e mësimnxënies - ku grupet e punëtorëve mbledhen rregullisht së bashku me qëllim parësor të mësimnxënies më të shumtë rreth kërkesave të organizimit të punës, procedurave të punës dhe vendeve të punës. Ciklet e cilësisë dhe trajnimet e jashtme janë zbatuar nga një numër i kufizuar i ndërmarrjeve.

Tabela 13: Ofrimi i trajnimeve

	% e ndërmarrjeve	Nr. i vëzhgimeve
Të aftësuar në vitin 2016	30%	21
Trajnimet në vendin e punës	55%	39
Ciklet e mësimnxënies	37%	26
Ciklet e cilësisë	14%	10
Trajnimet e jashtme	7%	5

Burimi: Të dhënat nga anketa

2.4.5 Bashkëpunimi mes punëdhënësve dhe ofruesve të fuqisë punëtore

Ky studim tregon se ekziston një bashkëpunim i dobët ndërmjet sektorit privat dhe sistemit të arsimit dhe aftësimin, në veçanti mes shkollave të AAP-ve dhe QAP-ve (Tabela 14). Vetëm 16 përqind e ndërmarrjeve në këtë sektor kanë ofruar stazhe për praktikantë për shkollat e AAP-së, vetëm 11 përqind e ndërmarrjeve janë angazhuar në hartimin e kurrikulave të AAP-së dhe një pjesë disi më e lartë e tyre (19%) janë vizituar nga nxënësit e AAP-ve.

Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë është më i zhvilluar, sa i përket tri aspekteve të studiuara. Gati 30 përqind e ndërmarrjeve kanë ofruar vende për praktikantë për studentët e arsimit të lartë, 25 përqind kanë kontribuar në zhvillimin e programeve të studimit në arsimin e lartë dhe 31 përqind e ndërmarrjeve kanë qenë nikoqir të vizitave të organizuara për studentët nga arsimi i lartë.

Tabela 14: Bashkëpunimi mes sektorit të ndërtimitarisë, atij arsimor dhe ofruesve të trajnimit

Bashkëpunimi me shkollat për AAP	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve
Ofrimi i vendeve për praktikantë	16%
Kanë kontribuar në hartimin e kurrikulave	11%
Vizitat e studentëve	19%
Bashkëpunimi me institucionet e AL	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve
Ofrimi i vendeve për praktikantë	27%
Kanë kontribuar në hartimin e kurrikulave	25%
Vizitat e studentëve	31%
Bashkëpunimi me QAP	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve
Trajnimet për pjesëmarrësit në QAP	4%
Kanë kontribuar në hartimin e programeve të trajnimit	4%
Vizitat nga ana e pjesëmarrësve në QAP	11%

Burimi: Të dhënat nga anketa

Të dhënat zbulojnë se bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe QAP-ve është pothuajse inekzistent. Shumë pak ndërmarrje kanë pranuar nxënës të trajnuar nga QAP-at, janë angazhuar në hartimin e programeve të trajnimit ose janë vizituar nga pjesëmarrësit e trajnuar pranë QAP.


3. Shkathtësitë e nevojshme për punëtorët për vendosjen e betonit, përfunduesve të betonit dhe të ngjashëm

Sipas klasifikimit ISCO-08, punëtorët për vendosjen e betonit, përfunduesve të betonit dhe të ngjashëm ngrejnë korniza dhe struktura të betonit të përforduar, ndërtojnë forma për derdhjen e betonit, përfordojnë sipërfaqet prej betonit, hapësira të çimentuara në mure ose gypat për puse, përfundojnë dhe riparojnë sipërfaqet e çimentos dhe kryejnë punë për ndërtimin e tarracave.

3.1 Arsimi, vështirësitë në plotësimin e vendeve të lira të punës dhe ofrimin e trajnimeve

Ekziston një mospërputhje e dukshme mes nivelit/llojit aktual dhe të preferuar të arsimit për punëtorët e betonit (Figura 6). Sipas të dhënave të mbledhura për këtë studim, 81 përqind e ndërmarrjeve të sektorit të ndërtimit kanë deklaruar se një punëtor i zakonshëm i betonit në Kosovë ka të përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm (gjimnazin), ndërkohë që ky lloj arsimit preferohet nga vetëm 24 përqind e ndërmarrjeve. Në anën tjetër, vetëm 10 përqind e ndërmarrjeve kanë deklaruar se një punëtor tipik ka të përfunduar shkollën për AAP, ndërsa për pothuajse dy të tretat e tyre ky shkollim paraqet nivelin dhe llojin më të dëshiruar të arsimit. Për shkak të kësaj mospërputhje, të gjitha ndërmarrjet ofrojnë trajnime fillestare, ndonëse shumica e tyre ofrojnë një muaj trajnim (75%), por ka edhe ndërmarrje që ofrojnë trajnime mes 6-12 muajsh (13%). Arsimi i lartë duket të mos jetë i pranishëm dhe as i preferuar në këtë sektor.

Figura 6: Niveli/lloji tipik dhe i preferuar i arsimit për punëtorët e betonit



Burimi: Të dhënat nga anketa

Sektori shoqërohet edhe me vështirësi në plotësimin e vendeve të lira të punës për punëtorët e betonit, pasi që 52 përqind e 62 ndërmarrjeve kanë raportuar vështirësi të tilla (Tabela 9). Për të adresuar nevojat për shkathtësi të reja për punëtorët e betonit, ndërmarrjet kryesisht zgjedhin të trajnojnë punëtorët e tyre dhe/ose të bëjnë riorganizimin e brendshëm për të shfrytëzuar më mirë shkathtësitë dhe kompetencat ekzistuese në vend të rekrutimit të stafit të ri (Tabela 15).

Tabela 15: Përgjigje në shkathtësitë e reja

Mekanizmat për adresimin e nevojave për shkathtësi të reja	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve
Aftësimi i stafit në dispozicion	44%
Riorganizimi i brendshëm për shfrytëzimin më të mirë të shkathtësive ekzistuese	45%
Rekrutimi i stafit të ri	13%

Burimi: Të dhënat nga anketa

Rreth një e katërta e ndërmarrjeve kanë deklaruar se kanë pasur vështirësi në gjetjen e kurseve ose trajnerëve për shkathtësitë e reja të nevojshme për punëtorët e betonit.

3.2 Detyrat dhe shkathtësitë specifike të profesionit të punëtorëve të betonit

Për secilën nga detyrat e punëtorëve të betonit, sipas klasifikimit ISCO, firmave të anketuara u është kërkuar që të përgjigjen në pyetjet në vijim: nëse punëdhënësit në këtë profesion kryejnë punë të tilla; nëse ndërmarrjet konsiderojnë se këta punëtorë do të duhej të kryejnë punë të tilla; dhe nëse rëndësia e kësaj detyre, në të ardhmen, do të ketë rënie, do të mbetet e njëjtë ose të bëhet më e rëndësishme. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se punëtorët e betonit në sektorin e ndërtimit në Kosovë kryejnë punë të ngjashme me përkufizimet e ISCO-08 (Tabela 15).

Më shumë se 90 për qind e ndërmarrjeve deklaruan se punëtorët e betonit ndërtojnë dhe riparojnë dysheme, mure, rezervuar, silos dhe struktura të tjera prej betoni të armuar, 80 për qind e të cilave parashikojnë se rëndësia e kësaj pune do të mbetet ose do të rritet sa i përket rëndësisë së saj.

Detyra për krijimin e kornizave ose montimin e formave të parafabrikuara të tyre për derdhjen e betonit kryhet nga punëtorët e betonit në 89 për qind të ndërmarrjeve. Për shumicën dërrmuese të ndërmarrjeve, kjo detyrë pritet të mbetet e njëjtë ose të rritet për nga rëndësia.

Hapësirat e çimentos në mure ose derdhje betoni për puse realizohen nga punëtorë e betonit në 76 ndërmarrje dhe rëndësia e saj do të mbetet e njëjtë ose do të rritet në të ardhmen për gati 80 përqind të ndërmarrjeve.

Për shumicën e ndërmarrjeve (78%), punëtorët e betonit kryejnë përfundimin dhe rrafshimin e sipërfaqeve të strukturave prej betoni dhe zbatojnë shtrirjen e një shtrese të fortë dhe të lëmueshme të përbërë nga çimento, pigmente rëre dhe grimca mermeri në dysheme, të njohur si një përfundim i terracës. Një numër i ngjashëm i ndërmarrjeve parashikon se rëndësia e këtyre punëve do të mbetet e njëjtë ose do të rritet.

Tabela 16: Detyrat e një punëtori të betonit

Punët	Punëtorët e betonit e kryejnë këtë punë	Punëtorët e betonit do të duhej ta kryejnë këtë punë	Rëndësia e kësaj pune do të mbetet e njëjtë ose do të rritet
Ndërtimin dhe përforcimin i dyshemeve, mureve, rezervuarve, sillosëve dhe strukturave tjera prej betoni	93%	90%	87%
Krijimi i kornizave apo montimi i formave të parafabrikuara të tyre për derdhjen e betonit	89%	83%	90%
Çimentimi i hapësirave në mure apo gypave për puse	76%	75%	78%
Përfundimi dhe lëmuarjen e sipërfaqeve të strukturave prej betoni	80%	78%	78%
Zbatimi i shtrirjes së një shtrese të fortë dhe të lëmueshme të përbërë nga çimento, pigmente rëre dhe grimca mermeri në dysheme, të njohur si përfundim i terracës	80%	78%	78%

Burimi: të dhënat nga anketa

3.3 Shkathtësitë që kërkohen për kryerjen në mënyrë adekuate të detyrave nga ana e një punëtori të betonit

Për secilën nga detyrat e listuar, punëdhënësit janë pyetur që të përmendin tri shkathtësitë kryesore. Gjetjet për secilën detyrë janë dhënë në kutitë në vijim.

Detyra 1: Ndërtimi dhe përforcimi i dyshemeve, mureve, rezervuarve, sillosëve dhe strukturave tjera prej betoni të përforcuar

- Përforcimi i dyshemeve prej betoni;
- Ndërtimi i strukturave;
- Përcaktojnë format që bartin beton sipas pjerrtësisë dhe thellësisë së dëshiruar dhe renditjen e tyre;
- Shpërndan betonin në mure;
- Derdhjen e betonit;
- Bënë pozicionimin e formave apo kornizave ndërtimore;
- Çimentimi i hapësirave në mure;
- Nivelizimi dhe lëmuarja e betonit; dhe
- Kontrollon kornizat që mbajnë betonin për të parë nëse ato janë ndërtuar si duhet.

Detyra 2: Bërjen e kanatave ose montimin e formave të parafabrikuara për derdhjen e betonit

- Bërjen e kanatave;
- Hapjen e kanatave;
- Montimi i kanatave;
- Shkathtësitë në punimin me kanata;
- Riparimi i kanatave;
- Identifikimi i kornizës së punës; dhe
- Përgatitjen e formave prej betoni.

Detyra 3: Çimentimi i hapësirave në mure apo gypave për puse

- Çimentimi i hapësirave;
- Përgatitja e betonit;
- Strukturimi i betonit; dhe
- Aplikimi i aditivave

Detyra 4: Përfundimin dhe lustrimin e sipërfaqeve të strukturave të betonit

- Përfundimi i betonit;
- Nxjerrja e strukturave prej betoni;
- Përgatitja e substancave rezistente;
- Shpërndarja, nivelizimi dhe lëmuarja e betonit duke përdorur grabujë, lopatë, mistri dore apo në formë makine, rrafshuese betoni me dorë apo në formë makine dhe makine për lustrimin e betonit
- Shpërndarja dhe nivelizimi i dyshemesë;
- Punët përfundimtare të terracimit; dhe
- Matjen e përbërjes së materialeve dhe betonit.

Detyra 5: Aplikimin e një shtrese rezistente të përbërë prej çimentoje, pigmenti rëre dhe mermeri i njohur si veshje tarrace

- ✓ Nivelizimi i betonit;
- ✓ Shpërndarja e çimentos;
- ✓ Kombinimin e materialeve;
- ✓ Kontrollin e kualitetit të betonit;
- ✓ Kontrollin e fortësisë së betonit; dhe
- ✓ Vendosjen/instalimin e dyshemesë prej mermeri.

Punëdhënësit paraqitën edhe njohuritë e domosdoshme që duhet t'i kenë punëtorët e betonit e të cilat janë listuar në vijim:

- Njohuri për pigmentet;
- Njohjen e makinave dhe veglave, duke përfshirë dizajnin, përdorimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Njohuri për lëmuarjen e sipërfaqeve;
- Njohuri për strukturat dhe kornizat e betonit;
- Njohuri për pigmentet; dhe
- Njohuri për punimin e sipërfaqeve të qëndrueshme të lëmuar të dyshemeve të përbërë nga çimento, pigmente të rërës dhe grimca mermeri.

3.4 Kërkesat për shkathtësi të përgjithshme

Tabela 17 paraqet kërkesat e disa prej shkathtësive kryesore të përgjithshme për punëtorët e betonit, të renditura sipas gjasave për rritjen e rëndësisë së tyre, ashtu si janë raportuar nga ndërmarrjet e anketuara. Gjetjet tregojnë se gjysma e punëdhënësve deklaruan se nuk kërkohet njohuri për lexim për të kryer punët e punëtorëve betonit, rreth 30 për qind deklaruan se këta punëtorë duhet të jenë në gjendje të lexojnë udhëzime dhe tekste të thjeshta, 15 për qind deklaruan se punëtorët e betonit duhet të jenë në gjendje për të lexuar përmbajtje komplekse dhe vetëm 7 për qind deklaruan se ata duhet të lexojnë tekste specifike të profesionit me pak përmbajtje teknike.

Ngjashëm me aftësitë e leximit, përgjigjet sa i përket kërkesave për shkathtësitë e të shkruarit, ndryshojnë nga një ndërmarrje në tjetrën. Gjysma e ndërmarrjeve deklaruan se punëtorët e betonit duhet të jenë në gjendje të shkruajnë tekste të thjeshta, të plotësojnë formularët dhe vetë të përgatisin raporte (për 50% të ndërmarrjeve), sipas 17 përqind të ndërmarrjeve ata duhet të

jenë në gjendje të shkruajnë tekste që përshkruajnë përmbajtjen specifike të profesionit të tyre por, sipas 28 për qind të këtyre ndërmarrjeve, punëtorëve të këtij profesioni nuk u nevojitet shkrimi.


Nga punëtorët e betonit kërkohet të bëjnë llogaritjet e thjeshta dhe për disa punëdhënës, nga këta punëtorë kërkohet të llogarisin mesataret, përpjestimet, përqindjet etj. Gjysma e ndërmarrjeve raportojnë se për punëtorët e betonit kërkohen shkathtësi elementare të përdorimit të kompjuterëve, një e pesta kërkon që këta punëtorë të kenë shkathtësi për të punuar me aplikacionin për përpunimin e tekstit (word) dhe excel, ndërsa 15 për qind e ndërmarrjeve nuk kërkohen shkathtësi për përdorimin e kompjuterëve dhe 6 për qind kërkohen shkathtësi komplekse dhe të avancuara të përdorimit të kompjuterëve.

Tabela 17: Niveli i shkathtësive të domosdoshme të leximit, shkrimit, numërtimit dhe aftësive kompjuterike

Ndërmarrjet me shkathtësi të leximit	%
Për këtë vend pune nuk kërkohet lexim	49%
Leximi i udhëzimeve dhe teksteve të thjeshta	27%
Leximi i teksteve specifike profesionale me pak përmbajtje teknike	7%
Leximi dhe kuptimi i teksteve komplekse që janë të rëndësishme për punë	1%
Leximi i përmbajtjeve nga një kontekst i gjerë	15%
Shkathtësi të të shkruarit	
Për këtë vend pune nuk kërkohet shkrim	28%
Shkrimi i teksteve të thjeshta, plotësimi i formularëve, vet-raportimi për aktivitetet e punës	51%
Shkrimin e teksteve që përshkruajnë përmbajtjen specifike profesionale të njohur	17%
Shkrimin e teksteve specifike profesionale komplekse	4%
Shkrimin e analizave, raporteve që vlerësojnë një kontekst më të gjerë afarist	
Shkathtësi të numërtimit	
Nuk ka nevojë për këtë shkathtësi	3%
Kryerjen e llogaritjeve të thjeshta (mbledhjen, pjesëtimin, shumëzimin)	62%
Llogaritjen e mesatareve, përpjesëtimeve, përqindjeve, etj.	32%
Njohuri për metodat e avancuara të llogaritjeve dhe statistikore, etj.	3%
Hartimin e modeleve, treguesit e performancës, llogaritjet komplekse	
Shkathtësi për përdorimin e kompjuterit	
Asnjë	15%
Elementare (p.sh. futjen e të dhënave, dërgimin dhe pranimin e e-mail-ave, printimin)	53%
Mesatare (p.sh. përpunimin e tekstit, excel)	20%
Komplekse (p.sh. analizën e informatave apo dizajnin duke përfshirë dizajnit përmes kompjuterit; përdorimin e pakove për analizat statistikore)	6%
Të avancuara (p.sh. programimin softuerik, menaxhimin e rrjetave kompjuterike)	6%

Një pjesë e madhe e punëdhënësve presin që në të ardhmen, rëndësia e shkathtësive të leximit, të shkrimit, të numërtimit dhe të përdorimit të kompjuterëve do të mbetet e njëjtë ose në rritje. Megjithatë, mes 20-28 për qind e punëdhënësve deklaruan se sistemi i arsimit po përgatit, në mënyrë të duhur, një fuqi punëtore për katër shkathtësitë e përmendura. (Figura 7).

Figura 7: Rëndësia e pritshme dhe disponueshmëria e shkathtësive



Burimi: të dhënat nga anketa

Shkathtësitë e tjera të përgjithshme që kërkohen për punëtorët e betonit janë të listuara në Tabelën 18. Për shumicën dërmuese të punëdhënësve, punëtorët e betonit duhet të posedojnë shkathtësi për zgjidhjen e problemeve, kreativitet/inovacion, të jenë të zhdërvjelltë, shkathtësi për të punuar në grup, shkathtësitë e shitjes, shkathtësitë në zbatimin e praktikave për të zvogëluar përdorimin e lëndës së parë, energjisë dhe ujit, shkathtësi në përcaktimin e detyrave të tyre dhe aftësinë për të ndërmarrë planifikimin e resurseve. Një gjetje e rëndësishme ka të bëjë me atë se ndërmarrjet kërkojnë që punëtorët e betonit të jenë në gjendje të mësojnë dhe të udhëzojnë homologët e tyre, e cila mund të lidhet me gjetjen se aftësimi në vendin e punës paraqet një mekanizëm kyç për zhvillimin e fuqisë punëtore.

Tabela 18: Shkalla e rëndësisë së shkathtësive tjera

Shkathtësitë	Shkathtësitë që kërkohen për punëtorët e betonit	Mbesin të rëndësishme/rëndësi a do të rritet
Zgjidhja e problemeve komplekse	99%	97%
Gjuhët e huaja	37%	69%
Zhdërvjelltësia	94%	96%
Shkathtësitë komunikuese	75%	83%
Puna ekipore	99%	99%
Shkathtësitë e shitjes	93%	94%
Shkathtësitë Kreative/Inovative	99%	99%
Shkathtësitë teknike	100%	99%
Shkathtësitë e mësimdhënies/udhëzuese	97%	97%
Zbatimi i praktikave për zvogëlimin e përdorimit të lëndës së parë, energjisë dhe ujit	96%	87%
Përcaktimi i detyrave të veta të punës	87%	90%
Shkathtësi në planifikimin e resurseve	86%	86%

Burimi: të dhënat nga anketa

Në përgjithësi, sipas punëdhënësve, rëndësia e shkathtësive të përgjithshme të përmendura më sipër ose do të mbetet e njëjtë ose do të ketë rritje gjë e cila ia bënë me dije sektorit të arsimit që me rastin e rishikimit dhe hartimit të kurrikulave, t'i marrë parasysh këto aspekte.

Gjuhët e huaja konsiderohen të rëndësishme për vetëm 37 për qind të ndërmarrjeve, megjithatë rëndësia e tyre pritet të rritet në të ardhmen. Sa i përket përgatitjes së tyre, vetëm një e katërta e ndërmarrjeve kanë deklaruar se punëtorët që vijnë drejtpërdrejt nga shkollat/universitetet janë të përgatitur mirë apo në mënyrë adekuate.

3.5 Shtytësit e ndryshimit, ndikimi në kërkesat për shkathtësi

Gjatë dy viteve të fundit, shumica e ndërmarrjeve kanë prezantuar organizimin e punës (87% e ndërmarrjeve të anketuara). Firmat, aktivitetet inovative të cilave i përketin kategorive të firmave në shitjeve dhe marketing përfaqësojnë 62 për qind, pasuar nga 49 për qind që përqendrohen në inovacionet në mallra dhe shërbime dhe 42 për qind e ndërmarrjeve kanë futur ndryshime në procese, qoftë për prodhimin e mallrave ose dhënien e shërbimeve.

Ndryshimet në organizimin e punës kanë ndikuar në detyrat e punëtorëve të betonit te gati dy të tretat e ndërmarrjeve, pasuar nga ndryshimet në praktikat e shitjes dhe marketingut, ndryshimet e proceseve, mallrave dhe shërbimeve (Tabela 19).

Tabela 19: Ndikimi i ndryshimeve/inovacioneve në detyrat e punëtorëve të betonit

Ndikimi i ndryshimeve/inovacioneve	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve
Proceset (për prodhimin e mallrave apo ofrimin e shërbimeve)	28%
Mallrat ose shërbimet	21%
Metodat e shitjes dhe marketingut	32%
Organizimi i punës	62%

Burimi: të dhënat nga anketa

Rezultatet e anketës zbulojnë atë që pothuajse gjysma e ndërmarrjeve kanë pësuar ndryshime sa i përket mbrojtjes së mjedisit, gjë e cila kanë çuar edhe në ndryshimin e detyrave të kryera gjatë punës me beton (në 43% të ndërmarrjeve).

Pesëdhjetë e dy për qind e firmave raportuan se nga të gjitha profesionet që ushtrohen nga firmat e anketuara, punëtorët e betonit aktualisht janë grupi më i prekur nga ndryshimet në detyrat e punës dhe kërkesat e shkathtësive. Kur u pyetën që të përmendin tri grupe tjera profesionale që janë duke kaluar nëpër ndryshimet më të mëdha, u përmendën: suvatuesit, punëtorët për ndërtimin e kulmeve, muratorë, punëtorët në izolim, etj.

3.6 Kushtet e punës dhe përgatitja fizike e punëtorëve që kërkohet

Pak më shumë se gjysma e ndërmarrjeve deklaruan se punëtorët e betonit kryejnë detyrat e tyre qoftë jashtë por edhe në mjediset e punës, 37 për qind deklaruan se puna e punëtorëve të betonit kryhet në mjediset e punës; dhe pjesa e mbetur prej dhjetë për qind deklaruan se puna kryhet vetëm jashtë ambienteve të punës.

Përgjigjet e ndërmarrjeve tregojnë se punëtorët e betonit kryejnë detyrat e tyre në kushte të vështira pune (Tabela 20). Në ambiente të nxehta, të ftohta dhe në ambiente të ndryshme, në zhurmë, me erë janë kushtet e punës të përshkruara që mbizotërojnë.

Tabela 20: Kushtet e punës

	% e ndërmarrjeve
Nxehtë	70%
Ftohtë	58%
Me erë	51%
Zhurma	69%
Ndryshimet e temperaturës	70%
Vibrimet	27%
Me lagështi	28%
Rrezatim	6%
Dritë artificiale	9%
Mjedis toksik	28%

Burimi: të dhënat nga anketa

Pothuajse të gjitha ndërmarrjet (89%) deklaruan se punëtorët e betonit duhet të kenë forcë fizike të konsiderueshme; 53.5 për qind deklaruan se duhet të jenë në gjendje të qëndrojnë, të ecin, të gjunjëzohen ose të shtrihen, për pjesën më të madhe të kohës së punës. Një e treta e ndërmarrjeve deklaruan se punëtorët e betonit duhet të kenë koordinim të mirë vizuel dhe vetëm 18 për qind thanë se këta punëtorët duhet të jenë në gjendje të qëndrojnë ulur shumicën e kohës.

4. Komente përmbyllëse dhe rekomandime

Sektori i ndërtimit mbetet një kontribues i rëndësishëm në BPV, qarkullim, IHD dhe punësim. Të dhënat e mbledhura nga kjo dhe pikat e mëparshme të hulumtimit tregojnë një rritje të mëtejshme të sektorit, të shoqëruar edhe me cilësi të shtuar, inovacion dhe investime. Në vitin 2015, gati tre mijë ndërmarrje vepronin në këtë sektor duke përfaqësuar një të dhjetën e qarkullimit vjetor në sektorin privat. Sipas të dhënave nga Anketa e Fuqisë Punëtore, sektori punëson rreth 15 për qind të punëtorëve nga numri i përgjithshëm i dominuar shumë nga meshkujt ndërsa femrat përfaqësojnë vetëm një për qind të punësimeve të përgjithshme në sektor.

Bazuar në zhvillimet e viteve të mëparshme dhe gjetjet nga ky anketim, sektori pritet të ketë rritje të mëtejme. Një numër i madh i ndërmarrjeve të intervistuar (rreth dy të tretat e tyre) parashikojnë një rritje të sektorit, të matur sipas numrit të punësimeve dhe qarkullimit. Në përputhje me pritjet e tyre pozitive, shumica e ndërmarrjeve planifikojnë të investojnë në tokë, ndërtesa dhe makinë.

Kërkesa për punë, e matur nga numri i vendeve të lira të punës po zbulon një rritje të konsiderueshme të kërkesës. Sipas të dhënave të mbledhura për këtë studim, profesionet më të zakonshme që punësojnë pjesën më të madhe të punëtorëve në këtë sektor janë: punëtorët e betonit dhe përfunduesit e punëve të betonit, muratorët, punëtorët për ndërtimin e kulmeve, punëtorët e izolimit; suvatuesit; shtruesit e dyshemeve dhe punëtorët për ngjyrosje.

Në përputhje me dëshmitë e mëparshme, ky studim konstaton se ndërmarrjet po përballen me vështirësi në plotësimin e vendeve të lira të punës për profesione e caktuara të sektorit. Si rezultat i kësaj, ndërmarrjet po përfundojnë në punësimin e punëtorëve të pakualifikuar duke çuar në uljen e produktivitetit të punës dhe kostove shtesë për trajnimin e punëtorëve të punësuar rishtas.

Ofruesit e fuqisë punëtore për sektorin janë shkollat profesionale, Qendrat e Aftësisit Profesional të Agjencisë së Punësimit dhe Institucionet e Arsimit të Lartë. Në vitin 2016, kishte 908 nxënës në shkollat e AAP-së; 457 persona të papunë u aftësuan në Qendrat e Aftësisit

Profesional dhe 2,524 studentë po studionin në programet e ndërtimitarisë në arsimin e lartë. Një tendencë për rënie në regjistrim është vërejtur në shkollat e AAP-ve por një rritje në arsimin e lartë dhe në QAP-t.

Në përgjithësi, ekziston një bashkëpunim i dobët midis sektorit privat dhe ofruesve të arsimit dhe aftësisit. Shumë pak ndërmarrje kanë akomoduar studentët nga qendrat për AAP për qëllime të stazhit dhe pak ndërmarrje janë angazhuar në zhvillimin e kurrikulave. Megjithatë Qendrat e Aftësisit Profesional mund të shërbejnë për ri-aftësimin e të punësuarve, të dhënat tregojnë se kjo mundësi është përdorur shumë rrallë. Kjo nënkupton humbjen e mundësive për ndërmarrjet që të përfitojnë nga aftësimet falas të ofruara nga këto qendra por, kanë humbur edhe mundësinë që QAP-të të marrin informacione të dorës së parë mbi kërkesat e tregut të punës për shkathtësitë e nevojshme.

Sektori po kalon nëpër ndryshime, përmes inovacioneve në organizimin e punës, proceseve të shitjes dhe marketingut, produkteve dhe shërbimeve, ndryshimin e proceseve. Kjo vë presion shtesë mbi sistemin e arsimit dhe aftësisit duke kërkuar harmonizimin e tyre me zhvillimet e sektorit.

Gjetjet sa i përket shkathtësive të nevojshme për punëtorët vendosjen e betonit, të punëtorëve për përfundimin e betonit dhe punëtorëve të ngjashëm

Punëtorët e betonit janë të punësuar në pothuajse të gjitha ndërmarrjet dhe përbëjnë një fuqi punëtore të konsiderueshme të sektorit. Sektori synon të diplomuarit nga qendrat për AAP por, shumica e tyre kanë vështirësi në plotësimin e vendeve të lira. Për pasojë, ndërmarrjet kryesisht punësojnë të diplomuarit nga gjimnazet të cilët nuk posedojnë njohuri dhe shkathtësi specifike profesionale.

Në përgjithësi, bazuar në të dhënat për detyrat specifike profesionale, punëtorët e betonit kryejnë detyra të ngjashme me ato të përcaktuara në klasifikimin ISCO-08; të cilët duhet të jenë në gjendje të kryejnë detyrat në vijim:

- ✓ Ndërtimi dhe përforcimi i dyshemeve të betonit të përforcuar, mureve, rezervuarëve, silloseve dhe strukturave të tjera të betonit;
- ✓ Bërjen e kanatave ose montimin e formave të parafabrikuara të tyre për derdhjen e betonit;
- ✓ Hapësirat e çimentos në mure ose derdhje betoni për puse;
- ✓ Përfundimin dhe lëmuarjen e sipërfaqeve të strukturave të betonit; dhe
- ✓ Shtrimin sipërfaqeve të qëndrueshme të lëmuar të përbërë nga çimento, pigmente rëre dhe grimca mermeri në dysheme, të njohura si përfundimi terracor.

Siç është deklaruar nga ndërmarrjet, pritet që në të ardhmen, rëndësia e detyrave të përmendura të mbetet e njëjtë ose të rritet. Për secilën nga detyrat, ndërmarrjet kanë listuar një numër të shkathtësive të cilat shërbejnë si një bazë e shëndoshë në zhvillimin e standardeve profesionale.

Nga ajo që gjetjet kanë zbuluar, për punëdhënësit, shkathtësitë përfshijnë jo vetëm shkathtësi të caktuara profesionale por edhe ato të përgjithshme të cilat do t'u mundësonin punëtorëve të betonit të kryejnë siç duhet detyrat në vijim:

- ✓ Leximi i udhëzimeve dhe teksteve të thjeshta;
- ✓ Shkrimin e teksteve të thjeshta, plotësimin e formularëve dhe përgatitjen e raporteve të veta;
- ✓ Llogaritjet e thjeshta, llogaritjen e mesatares, përpjesëtimeve, përqindjen; dhe
- ✓ Përdorimin e kompjuterëve (shkathtësi elementare);

Përderisa rëndësia e shkathtësive të leximit, shkrimit, numërimit dhe të përdorimit të kompjuterit pritet të mbetet e njëjtë ose të rritet, një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve deklaruan se këto shkathtësi nuk fitohen gjatë arsimimit.

Punëtorët e betonit duhet të pajisen me shkathtësi për zgjidhjen e problemeve, kreativitet/inovacion, zhdërvjelltësi, punës në grup, shkathtësitë e shitjes, shkathtësitë në zbatimin e praktikave për të zvogëluar përdorimin e lëndës së parë, energjisë dhe ujit, shkathtësitë në përcaktimin e detyrave të tyre dhe atyre për planifikimin e resurseve, ata duhet të jenë në gjendje të japin mësim dhe t'i udhëzojnë homologët e tyre. Rreth 40 përqind e ndërmarrjeve deklaruan se punëtorët e betonit duhet të njohin edhe gjuhë të huaja dhe një pjesë e madhe e tyre deklarojnë se rëndësia e këtyre shkathtësive do të mbetet e njëjtë ose do të rritet në të ardhmen.

Duke u nisur nga këto gjetje, rekomandimet kryesore për krijimin e një fuqie punëtore me gjasa më të mëdha për punësim, e më këtë ndërmarrje më efektive dhe produktive, janë si më poshtë:

- Bashkëpunimi ndërmjet punëdhënësve dhe ofruesve të arsimit dhe aftësimit duhet të forcohet. Ky është një parakusht kryesor në përafrimin e nevojave të tregut të punës me ofertën e arsimit dhe aftësimit. Kjo do të sigurojë që të diplomuarit dhe të aftësuarit të fitojnë njohuritë dhe shkathtësitë që kërkohen duke pasuruar kështu ofrimin e një fuqie punëtore që do të jetë në dispozicion të sektorit privat. Kjo gjithashtu do të sigurojë përdorimin efikas të fondeve publike;
- Përshpejtimin e procesit të standardeve profesionale për profesionet kyçe. Ky studim vlerëson kërkesën e tregut të punës në nivelin e profesional duke përmbushur një nga kriteret kryesore për zhvillimin e standardeve profesionale. Prandaj, gjetjet duhet të shfrytëzohen për zhvillimin e standardeve profesionale për punëtorët për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe punëtorët e ngjashëm;
- Vlerësimi i ngjashëm i shkathtësive të nevojshme sikur ky, duhet të ndiqet për profesione të tjera më intensive të punës, veçanërisht për muratorët, punëtorët për ndërtimin e kulmeve, punëtorët e izolimit, suvaturesit, shtruesit e dyshemeve dhe punëtorët për ngjyrosje;
- Shkathtësitë praktike/teknike janë të një rëndësie qendrore për profesionet specifike të sektorit;
- Megjithëse në shkollë mund të mësohen një sërë shkathtësish, praktikat profesionale të kryera në punëtoritë e shkollave ofrojnë një ambient të simuluar në vend të një mjedidi të vërtetë pune. Për të mbështetur punësimin dhe për të lehtësuar rrugën e suksesshme të karrierës, praktika profesionale në mjediset e punës është e një rëndësie vendimtare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sektorin e ndërtimit. Edhe nëse shkollat janë të pajisura plotësisht, detyrat e punëtorëve të betonit nuk mund të kryhen tërësisht në punëtoritë dhe lokalet e shkollave; Siç theksohet në NDS 2016-2020, deri më tani ndërmarrjet nuk kanë pasur ndonjë motivim për të marrë në punë praktikantët. Prandaj, ekziston nevoja për të hartuar dhe pilotuar një qasje të punës për të nxitur ndërmarrjet që të ofrojnë kryerjen e stazhit. Qasjet e qëndrueshme janë ato që nxisin përfitime për të dyja palët, punëdhënësit dhe praktikantët;
- Qendrat e Aftësimit Profesional duhet të bashkëpunojnë ngushtë me punëdhënësit, pasi kjo do të sjellë përfitime të dyfishta: së pari do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të punonjësve në këtë sektor dhe së dyti do t'i mundësojë QAP-ve të marrin informacion të

përditësuar dhe pa pagesë për zhvillimet në tregun e punës gjë e cila do të përdorej për rishikimin e kurrikulave të aftësimit;

- Ka nevojë që të adresohet përsëri ndarja gjinore profesionale. Bazuar në diskutimet me punëdhënësit, ka disa punë që femrat mund të kryejnë në sektorin e ndërtimit. Prandaj, shkollat duhet të hartojnë materiale të duhura informative dhe stimuj për të motivuar regjistrimin e vajzave në profesione të lidhura me ndërtimtari. Përveç kësaj, aktiviteti i MASHT-it për “Ditët e Vajzave” duhet të organizojë vizita edhe në kompanitë e ndërtimit;
- Duhet adresuar sfidat e vazhdueshme të mungesës së shërbimeve për udhëzimet lidhur me karrierën. Duhet të ofrohen orientime të hershme për karrierën gjë e cila mund edhe të çojë drejt përmirësimit të imazhit të arsimit të nxënësve të regjistruar në shkollat për AAP;
- Përveç shkathtësive specifike profesionale, të diplomuarit dhe të aftësuarit duhet të pajisen me shkathtësi të përgjithshme. Rëndësia e këtyre shkathtësive është nxitur nga ndryshimet në shijen e konsumatorëve dhe nga rritja e standardeve të cilësisë për ndërtimin; dhe
- Duket se ekziston nevoja për të pasuruar ofertën e aftësimeve dhe për të përgatitur siç duhet ekspertë të aftë për të ofruar kurse të aftësimit për punëtorët e betonit.

Referencat

- ALLED, 2016a. Metodologjia e zhvillimit të një profili të sektorit, Kosovë 2016, Prishtinë: <http://www.alledkosovo.com/methodology-manual/>.
- ALLED, 2016b. Agrikultura. Prishtinë: <http://www.alledkosovo.com/agriculture-manual/>
- INDEP, 2015, Aftësimi Profesional në Kosovë: Hollësitë, Marrëdhëniet dhe Problemet: http://www.indep.info/documents/27006_INDEP_Vocational%20Training%20in%20Kosovo%20-%20Features,%20Relationships%20and%20Problems-ëeb.pdf
- KOSME, 2014, Raporti për NVM-t në Kosovë 2014: http://www.eciks.org/repository/docs/Report_on_State_of_SMEs_in_Kosovo_2014_99378.pdf
- Qeveria e Kosovës, 2015, Strategjia Kombëtare Zhvillimore 2016-2020 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf
- Qeveria e Kosovës, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021.pdf> MCVET, 2008. Studim i Sektorit të Drurit: Raport hulumtimi për shkathtësitë e nevojshme. Vilnius: MCVET.
- MPMS, Puna dhe Fuqia Punëtore 2014, <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/ShpalljePublikime/Raporti%20Vjetor%202014%20-%20Shqip.pdf> (të dhënat për vitet 2012-2014)
- MTI dhe UNDP, 2014. Profili i Sektorit të Industrisë së Përpunimit të Drurit. Prishtinë: MTI dhe UNDP.
- MTI dhe UNDP, 2015. Tregjet potenciale të eksportit për sektorët për përpunimin e ushqimit, bujqësi, përpunimin e drurit, materialin ndërtimor, turizëm dhe atyre artizanale. Prishtinë: MTI dhe UNDP.
- MTI, 2014. Koncepti i Politikave Industriale në Kosovë. Prishtinë: MTI.
- Riinvest Institute, 2013, Të paguash apo të mos paguash: Një këndvështrim afarist për informalitetin në Kosovë.
- S&D (Strategy and Development Consulting), 2015, Vlerësimi i tregut për sektorin e ndërtimtarisë: Perspektiva e të rinjve për punësim.
- USAID, 2015a. Raporti i Vlerësimit dhe Selektimit të Sektorit të Kosovës: Një vlerësim i mundësive të rritjes, sfidave dhe mundësisë së ndikimit. USAID. Prishtinë.
- USAID, 2015b. Vlerësimi i sektorit të drurit në Kosovë: 2015 Përditësim për mundësitë dhe sfidat. USAID: Prishtinë.

Shtojca 1: Profesionet në sektorin e shkathtësive të Ndërtimit (ISCO-08)

13	Menaxherët e Prodhimit dhe Shërbimeve të Specializuara
132	Menaxherët e Prodhimit, Xehetarisë, Ndërtimit dhe Distribuimit
1323	Menaxherët e Ndërtimit
21	Profesionistët e Shkencës dhe Inxhinierisë
216	Arkitektët, Planifikuesit, Hulumtuesit dhe Projektuesit
2161	Arkitektët e Ndërtimtarisë
31	Bashkëpunëtorët Profesional të Shkencës dhe Inxhinierisë
312	Mbikëqyrësit e Prodhimit, Xehetarisë, Ndërtimit
3122	Mbikëqyrësit e Ndërtimtarisë
7	Punëtorët e Zejes dhe profesioneve të ngjashme
71 Punëtorët e ndërtimit dhe profesioneve të ngjashme (duke përjashtuar elektrikistët)	
711	Punëtorët e kornizave të ndërtimit dhe profesionet e ngjashme
7111	Ndërtuesit e shtëpive
7112	Muratorët dhe punëtorët e ngjashëm
7113	Gurghendës, Punëtorët për prerjen e gurit
7114	Punëtorët për vendosjen e betonit, përfundimin e betonit dhe punëtorët e ngjashëm
7115	Marangozë (zdrukthëtarë) dhe mobilier
7119	Punëtorët e kornizave të ndërtimit dhe profesionet e ngjashme që nuk janë klasifikuar diku tjetër
712	Përfunduesit e ndërtimit dhe punonjësit e profesioneve të ndërlidhura
7121	Punëtorët për ndërtimin e kulmeve
7122	Shtruesit e dyshemesë dhe punëtorët për vendosjen e pllakave
7123	Suvatues
7124	Punëtorët për Izolim
7125	Xhampunues
7126	Hidraulikët (ujësjellësit) dhe punëtorët për vendosjen e tubave
7127	Mekanikët për Kondicioner dhe Pajisje Ftohëse
713	Punëtorët për ngjyrosje, pastruesit e strukturës së ndërtesës dhe punëtorë e profesioneve të ngjashme
7131	Punëtorët për ngjyrosje dhe punëtorët e ngjashëm
7132	Punëtorët për ngjyrosje me sprej dhe me llak
7133	Pastruesit e Strukturës së Ndërtesës
Operues i Makinave për Lustrimin e Betonit – 8114	
9	Profesionet elementare
93 Punëtorë në Miniera, Ndërtim, Prodhim dhe Transport	
931	Punëtorët në Minierave dhe Ndërtim
9313	Punëtorët në ndërtimin e Ndërtesave



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

